



BILIK E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr/Br.

1110/20

Datë/Datum.

12.01.21

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr.1110/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomik NNT “VEHA” Vehbi Manaj B.I Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik “ACTIVA GROUP shpk & BENITA COMPANY -Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe rregullimi i lumenjve në Komunë - Reqan ,Mushtisht ,Terrnje ,Gelancë ,Vraniq ,Semetisht ,Leshan ,Sopijë-Faza e dytë me nr. të prokurimit: 624-20-5683-521 me nr. Brendshëm 624-020-110-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal Suharekë”, më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorëve Ekonomik NNT “VEHA” Vehbi Manaj B.I Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe rregullimi i lumenjve në Komunë - Reqan ,Mushtisht ,Terrnje ,Gelancë ,Vraniq ,Semetisht ,Leshan ,Sopijë-Faza e dytë me nr. të prokurimit: 624-20-5683-521 me nr. Brendshëm 624-020-110-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal Suharekë”.

II. VËRTETOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe rregullimi i lumenjve në Komunë - Reqan ,Mushtisht ,Terrnje ,Gelancë ,Vraniq ,Semetisht ,Leshan ,Sopijë-Faza e dytë me nr. të prokurimit: 624-20-5683-521 me nr. Brendshëm 624-020-110-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal Suharekë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupi të operatorëve ekonomik ankues NNT “VEHA” Vehbi Manaj B.I Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik NNT “VEHA” Vehbi Manaj B.I Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 18.12.2020 me nr. 1110/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi dhe rregullimi i lumenjve në Komunë - Reqan ,Mushtisht ,Terrnje ,Gelancë ,Vraniq ,Semetisht ,Leshan ,Sopijë-Faza e dytë me nr. të prokurimit: 624-20-5683-521 me nr. Brendshëm 624-020-110-521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “Kuvendi Komunal Suharekë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: nenin 61 të LPP-se dhe ka shkelur Rregullat për Tenderët Jo- Normalisht të Ulet - B57 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.12.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 30.12.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin 1

AK i Komunës Se Suharekës është dashur që në përputhje me Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulet neni 4 i kësaj rregullore të bëjë shpjegimet – arsyshmerin duke ja kërkuar Grupi i Operatorëve Ekonomik ACTIVA GROUP SH.P.K.; Benita Company, të jepe arsyetime duke shpjeguar çmimin e dhënë për artikujt e

caktuar 0.20 cent dhe artikujt jo normalisht te ulte duke nxjerr nga ky çmim shpenzimet , fitimin e pritur. Gjithashtu AK ka cekur ne Raportin e vlerësimit tek Hapi , Analiza e çmimit se ky Grup i Operatorëve Ekonomik ACTIVA GROUP SH.P.K.; Benita Company, është eliminuar për shkak te çmimit jo normalisht te ulet mirëpo ne funde është rekomanduar për kontratë është shume konfuze.

Eksperti mendon se pretendimi Ankimor është i bazuar dhe duhet te vlerësohen te gjitha Ofertat e përgjegjshme sipas Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht te Ule , neni 3 ne baze te shembullit te kësaj rregullore.

Nr.	Lot 1			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 6 oferta	Pranuar 6 oferta		
2		1	2,021,514.20	
3		2	1,334,220.45	
4		3	2,151,997.25	
5		4	1,899,832.59	
6		5	2,494,303.84	
7		6	1,987,499.90	
8		Total (C2+C3+C4+C5+C6+C7)	11,889,368.23	
9		mesatarja (C8/6)	1,981,561.37	
10	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	pragu 30% (mesatarja /1.3)	1,524,277.98	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
11	kushti 3 - pragu 10% ne	pragu 10% (oferta e dyte /1.1)	1,727,120.54	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin

mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire			e trete
---	--	--	---------

Ose

shembull qe duhet te merret per pozicionet-artikujt me çmimi te ulte për artikuj ku Unë e praktikoj për te kërkuar se cilat pozicione janë jo –normalisht te ulta.

Nr.	Përshkrimi i Artikujve	OE1	OE2	OE3	OE4	OE5	OE6	OE7	OE8	Mesatarja	Pragu 30%	Pragu 10%
1		2.34	2.45	2.60	3.00	2.38	2.59	2.50	2.35	2.53	1.94	2.13
2		6.57	3.30	1.00	2.00	1.40	1.70	0.35	3.40	2.47	1.90	0.91
3		5.44	2.96	5.00	6.00	3.50	3.50	3.00	5.00	4.31	3.32	2.73
4		6.29	2.82	6.00	0.50	3.00	3.80	3.50	5.00	3.86	2.97	2.56
5		7.55	4.07	1.00	8.00	4.00	4.00	3.50	6.00	4.77	3.67	3.18
6		4.20	1.35	4.00	3.60	3.00	2.50	2.00	3.00	2.96	2.27	1.82
7		0.01	0.04	0.03	0.03	0.03	0.02	0.02	0.02	0.03	0.02	0.02
8		0.01	0.04	0.01	0.01	0.03	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
9		0.02	0.04	0.05	0.04	0.05	0.04	0.04	0.04	0.04	0.03	0.04
10		0.04	0.04	0.01	0.01	0.05	0.04	0.04	0.04	0.03	0.03	0.04

Përgjigjeje ne pretendimin 2

Ne baze te te analizimit te Listës se Referencave te dorëzuar me oferte Grup i Operatorëve Ekonomik ACTIVA GROUP SH.P.K.; Benita Company, pretendim e ankimore i OE Anukues është pjesërisht i bazuar duke u bazuar pasi ne Listën e referencave dhe ne referenca/kontratë e dorëzuar janë te gjitha për shtrim te Asfalti te rrugëve ku dihet se ne pozicionet e asfaltit / rrugëve ka pozicione te ngjashme me kërkesën e Dosjes se tenderit Heqje , bartje te dheut apo ngjeshje te dheut etj etj eksperti konstaton se ky pretendim Ankimor te merret si pjesërisht i bazuar.

Duke u bazuar ne sqarimet e cekura me larte te gjetura ne ekspertizë lidhur me pretendimet Ankimore te te OE NNT “VEHA” Vehbi Manaj B.I Suhareke, ne tenderin me titull Pastrimi dhe rregullimi i lumenjëve në Komunë - Reqan ,Mushtisht ,Terrnje ,Gelancë ,Vraniq ,Semetisht ,Leshan ,Sopijë-Faza e dytë janë te bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar ne sqarimet e cekura me larte , Eksperti propozon OSHP-se qe Ankes e OE NNT “VEHA” Vehbi Manaj B.I Suhareke ne tenderin me titull Pastrimi dhe rregullimi i lumenjëve në Komunë - Reqan ,Mushtisht ,Terrnje ,Gelancë, Vraniq ,Semetisht ,Leshan ,Sopijë-Faza e dytë te aprovohet e bazuar e Aktiviteti i Prokurimit te kthehet ne **Ri-vlerësim**.

Autoriteti kontraktues me datë 05.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Pasi qe AK –ja ka kërkuar sqarim për çmim jo-normalisht te ulet për disa pozicione, ka pranuar sqarime dhe si te tilla ka pranuar deshmit, andaj kerkojm nga OSHP qe te vërtetoj njoftim vendimin e AK –Suharekë.

Operatori ekonomik me datë 31.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues ka të bëjë me tenderin e OE të rekomanduar, ku pretendon se AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk e ka trajtuar sipas këtij neni ofertën e OE që e ka shpallur fitues, si dhe kur të bëjmë analizën e çmimeve të ofruara nga tenderuesit, shihet se janë plotësuar tre kushtet e përcaktuara tek Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.

Për këtë pretendim ankimor, Paneli Shqyrtues sqaron se qëllimi i rregullave për tenderët jo normalisht të ulët është që të mos bëhet përjashtimi automatik në rastet kur për autoritetin kontraktues duket një tender jo normalisht i ulët. Mirëpo, përderisa autoriteti kontraktues konsideron se operatori ekonomik mund të përmbush kontratën me çmimet e ofruara dhe ka qëllim që fondet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, rezulton se nuk ka ndonjë kufizim apo pengesë për AK-në që të shpërblejë me kontratë. Megjithatë, Paneli Shqyrtues sqaron se fillimisht është përgjegjësi e AK-së që të vlerësoj nëse OE mund ta përmbush kontratën me këto çmime, si dhe është obligim i AK-së që të kërkoj nga OE i rekomanduar që të rrit sigurimin e ekzekutimit në rast se dështon të përmbush kontratën.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konsideron se është përgjegjësi e autoriteti kontraktues që të shpërblejë me kontratë operatorin ekonomik i cili ka ofruar çmime më të lira se çmimet e tregut dhe obligohet autoriteti kontraktues që të kërkoj nga OE i rekomanduar që të rrit sigurinë e ekzekutimit në rast të mos përmbushjes së kontratës, krejt kjo me qëllim të përdorimit dhe shfrytëzimit të fondeve publike në mënyrën më ekonomike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "Kuvendi Komunal Suharek";
- 1x1 OE NNT "VEHA" Vehbi Manaj B.I Suhareke;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.